

VENDIM
Nr. 87, datë 9.6.2016

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË
“E-VENTO SRL ALBANIA” SHPK, PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË LICENCËS NR.
60, SERIA NPM08, “PËR NDËRTIMIN, INSTALIMIN, SHFRYTËZIMIN DHE
PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALE EOLIKE”, TË DHËNË
ME VENDIMIN NR. 84, DATË 17.7.2008, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë të elektrike”, neneve 5 dhe 6, të rregullores “Për procedurat e heqjes së një licence”, neneve 16, pika 2 dhe 18, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar, gerrat “a”, “d”, “e” të vendimit nr. 84, datë 17.7.2008, të Bordit të Komisionereve të ERE-s, pikave 1.2, 1.6 dhe 1.7 të kushteve të licencës nr. 60, seria NPM08, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 84, datë 17.7.2008, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.6.2016, mbasi shqyrtoi informacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE në licencën e shoqërisë “E-Vento s.r.l. Albania” sh.p.k.,

konstatoi se:

- Duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e investimit dhe me qëllim mbështetjen dhe nxitjen e ndërtimit të burimeve të rinovueshme të energjisë ERE ka pranuar kërkesat e shoqërisë “E-Vento s.r.l. Albania” sh.p.k., në lidhje me shtyrjen e afateve për realizimin e projektit, duke përfshirë këtu edhe kolaudimin e veprës.

- ERE ka miratuar shtyrjen e afateve me vendimet:

- vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 63, datë 22.9.2009;

- vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 55, datë 25.8.2010;

- vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 134, datë 15.11.2013.

- Me shkresën me nr. 171 prot., datë 20.2.2015, shoqëria “E-Vento s.r.l. Albania” sh.p.k., ka paraqitur një kërkesë tjetër për shtyrjen e afateve të licencës së ndërtimit të dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me nr. 84, datë 17.7.2008, i ndryshuar së fundmi me vendimin nr. 134, datë 15.11.2013.

- Mospërbushja e parashikimeve të pikës 1, germa “e”, të vendimit nr. 84, datë 17.7.2008, i ndryshuar, e bën licencën të pavlefshme.

- Kur nuk përmbushen kushtet thelbësore të licencës së dhënë, sipas ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ERE, me iniciativën e vet mund të heqë licencën.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “E-Vento s.r.l. Albania” sh.p.k, për zgjatjen e afatit të licencës nr. 60, seria NPM08, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 84, datë 17.7.2008, për ndërtimin, instalimin, shfrytëzimin e centraleve elektrike dhe prodhimin e energjisë elektrike nga Parku Eolik Sarandë.

2. Fillimin e procedurave për heqjen e licencës së shoqërisë “E Vento s.r.l Albania” sh.p.k., nr. 60, seria NPM08, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 84, datë 17.7.2008.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti